

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere**  
**Mbledhja nr.15**  
**Prishtinë, më 10.7.2024, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203**

## **PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Armend Muja, Kryetar, Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Enver Haliti, Jeta Statovci, , Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj dhe Duda Balje, anëtar.

**Munguan:** Ferat Shala dhe Visar Korenica, anëtar.

**Te ftuar:** Hekuran Murati-ministër i Ministrisë për Buxhet, Punë dhe Transfere

**Pjesëmarrësit tjerë:** Festim Bytyqi-Këshilltar-GP-AAK, Sanije Berisha-OSBE, Ema Krasniqi-KDI, Valjeta Shala – Gazetare-RTK, Sami Gashi- GP-LVV, Elsa Krasniqi-GP-LVV, Nexhmije Ahmeti - Zyrtare e Mediave- Kuvendi i Kosovës.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

### **Rendi i ditës**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë: 5.6.2024 dhe 19.6.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;**
- 4. Të ndryshme**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetari- Para se të miratojmë rendin e ditës propozoj edhe tri pika shtese në rendit të ditës:**

Pikat shtese janë si në vijim:

- 1. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asetet**
- 2. Shqyrtimi I Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe grupin e organizatat e Bankës Botërore;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK-Porta Globale;**

Kryetari pas votimit konstatoi se me shumicë votash u miratua rendi i ditës, me ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë: 5.6.2024 dhe 19.6.2024**

**Kryetari** - Pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë vërejtje në procesverbalet e datës 5.6.2024 dhe 19.6.2024 ,pasi qe nuk pati vërejtje Kryetari konstatoi se me shumicë votash, u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më datës 5.6.2024 dhe 19.6.2024

- 3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;**

**Kryetari**, thekoi se Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit përmban implikime buxhetore shtesë por te përballueshme për Buxhetin Republikën e Kosovës ndërsa amendamentet e propozuara nga komisionit funksional për projektligjin në fjalë nuk përmbajnë implikime shtesë.

**Ministri Murati**, theksoi lidhur me këtë Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit në të cilën bëhet fjalë për shuma të ulëta në raport me buxhetin e përgjithshëm, në kuadër të kufijve buxhetor mund të akomodohet pa asnjë problem. Shuma e këtij projektligji është 80 milion euro nuk e shoh si problem të akomodohet në kuadër te kufijve buxhetor.

**Kryetari**, thekoi se Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit përmban implikime buxhetore shtesë por te përballueshme për Buxhetin Republikën e Kosovës, ndërsa amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për projektligjin ne fjalë nuk përmbajnë implikime shtese.

Kryetari e hodhi ne votim dhe konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:.

## **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L--288 për Mbrojtjen e konsumatorit përmban implikime buxhetore shtesë, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, për Projektligjin nr.08/L--288 për Mbrojtjen e konsumatorit, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i komisionit funksional për Ekonomi Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asetet**

**Kryetari**, theksoi se Projektligji nr.08/L-295 për krypto-asetet, është shqyrtuar nga Komisioni Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, deklarohet për koston e Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek komisioni funksional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asetet nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, sa i përket përgjegjësive dhe aktiviteteve që dalin nga ky projektligj për Administratën Tatimore të Kosovës dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare, do të mbulohen nga ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe vlerësimet 2025-2026.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari e hodhi ne votim dhe konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

## **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L-295 për krypto-asete, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, për buxhetin e Republikës së Kosovës;
  2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional për Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asete nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- #### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe grupin e Organizatave të Bankës Botërore;**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 83, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare e shqyrton Komisioni përgjegjës-raportues. Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar Projektligjin nr.08/L-313 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend.

**Hekuran Murati:** Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, nga e cila si anëtare përfiton financiarisht për realizimin e projekteve që shpesh shërbejnë për tu përputhur me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Amendamenti i Marrëveshjes fshin Seksionin III, të Nenit 3 të Marrëveshjes për Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, ky seksion që kufizonte Bankën nga hyrja në garanci, huamarrje ose hua të drejtpërdrejta ku shuma e tyre nuk mund të tejkalonte një për qind të kapitalit të bankës, rezervave dhe sur plusit të pashlyer.

**Avdulla Hoti:** Nga materiali nuk e kisha të qartë se çka nënkupton kjo rezolutë dhe implikimet e saja për vendin. Me 10 korrik të viti 2023 u miratua kjo marrëveshje, a ka ndonjë arsye pse nuk është përcjellë deri me tani për ratifikim në Kuvend?

**Hekuran Murati:** Kjo rezolutë nënkupton ndryshimin që ka të bëjë me rritjen e mundësive a po fleksibilitetit në lidhje me Bordin ekzekutiv në kuadër të rrethanave, duke i parashikuar se çfarë ndryshime mund të vijnë. Me këtë zgjerohet hapësira e veprimit në Bordin ekzekutiv në mënyre që të jetë më fleksibil e mos të ketë nevojë sa herë që ndryshon diçka të mbliidhet Bordi i Guvernatorëve.

Sa i përket datës së miratimit të rezolutës, që është miratuar në vitin e kaluar, konsideroj se kanë qenë procedurat fillimisht brenda për brenda bankës e pastaj edhe tek ne për te proceduar marrëveshjen deri ne Kuvend për ratifikim .

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari e hodhi ne votim dhe konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:.

### **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet **Projektligji nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e grupit të Bankës Botërore.**

## **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK-Porta Globale;**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 83, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar Projektligjin nr.08/L-314 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e Bankës Botërore dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend.

**Hekuran Murati:** Ratifikimi i Marrëveshja së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, bëhet fjalë për projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK-Porta Globale në kuadër të programit të Bankës Evropiane për Investime Porta Globale, pra është një projekt për të cilin kemi pasur edhe një marrëveshje të miratuar në këtë Komision, bëhet fjalë për projektin 100 mgw parku solar në KEK, i cili kap shumën në vlerë prej 104 milionë euro, ku është e nënshkruar marrëveshja dhe është miratuar kredia me bankën KFW Gjermane me shumën 29 milionë euro dhe kemi përfituar garantin prej 32 milionë euro nga Banka Investive për Ballkanin Perëndimorë dhe kjo është komponentë e tretë e financimit, pra është kredia e cila është nënshkruar me EIB. Kredia do të disbursohet deri në 8 këste, kurse interesi përcaktohet në momentin kur bëhet kërkesa nga ana jonë për disbursim. Sa i përket datës së maturimit për secilit transfer, do të mbetet jo më herët se 4 vite dhe jo më vonë se 25 vite nga data e planifikuar e disbursimit.

**Pal Lekaj:** Ne po miratojmë marrëveshje ndërkombëtare po i kemi të ngrira, 300 milion euro nuk dimë kur do hiqen sanksionet, sado jemi të zbehtë me deklarime po pëson qytetari dhe vendi. Nuk ka muaj që nuk kërkohet të kemi marrëveshjet ndërkombëtare për investime, nëse si ministër keni informacione sa ka pësuar vendi në këtë drejtim, se është goxha shqetësuese për atë që e kanë marrë implementimin e marrëveshjes përveç deklaratave të zv. kryeministrit nuk kemi ndonjë informacion të saktë. Dua të dije si po shkon puna në këtë drejtim, u shpreh Lekaj.

**Hekuran Murati:** Si organizatë zbatuese është KEK-u, ne si Ministri e Financave vetëm i sigurojmë procedurat financiare. Banka KFW Gjermane në shumën 29 milionë euro dhe EIB 33 milionë euro, që bëjnë 62 milion euro kreditim, dhe 32 milionë euro të tjera grant WBIF, që është korniza investive për Ballkanin Perëndimor. Të gjitha këto janë miratuar në dhjetorin e viti të kaluar. Ky grant është i miratuar, nuk ka ndonjë pengesë për zbatimin e projektit, sepse masat mund të jenë për projektet që janë në vazhdimësi, por kjo kredi ka marrë dritën e gjelbër për vazhdimësi. Sa i përket heqjes së masave, Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet, siç e keni parë raportin është përgatit nga përfaqësuesi i lartë i BE-së dhe presim një vendimmarrje.

Sa i përket problemeve, ka disa raste të Ministria për Komunitete dhe Kthim që ka pasur fondet për mbështetje të komunitetit serb, që ka qenë bashkëfinansim me Bashkimin Evropianë këtu kanë pësuar zona ku është shumica serbe.

**Pal Lekaj:** Nuk po korrespondon me deklaratat e kryetarit dhe kryeministrit se situata në veri është e qetë, dhe kemi dëgjuar deklaratat nga kryetari i Kuvendit se do zhvillohet një luftë, këto deklaratat nuk janë të mira për vendin dhe investitorët. Është ndonjë prapavijë kjo, nuk besoj se është mirë që krerët e vendit të proklamojnë luftë. Këto deklaratat janë të pamatura. A jeni të koordinuar, me krerët e shtetit apo jo, pyeti Lekaj.

**Hekuran Murati:** Jemi të koordinuar, në të kaluarën rreziku ka ardhur edhe nga vetë brenda territorit kurse tash me rend dhe ligj nuk ka rrezik nga brenda, çka mund të ketë rrezik është jashtë vendit në këtë rast është Serbia. Deklarata ime është tërësisht në përputhje me deklaratat e kryetarit dhe kryeministrit, kurrë më qetë situata nuk ka qenë në veri, rreziku mbetet vetëm nga jashtë.

**Avdullah Hoti:** Me këtë marrëveshje a huazohen këto mjete tek KEK-u, a i paguan KEK-u apo Buxheti i Shtetit. Me Buxhetin e vitit 2025 a keni parapa kthimin e borxhit nga kjo marrëveshje. Këstet e kredisë nga kush paguhen nga buxheti i shtetit apo nga KEK-u. KEK-u nuk është në buxhetin e shtetit dhe nëse e kthen borxhin prej kësaj marrëveshje ajo nuk reflekton në buxhetin e shtetit. Sa vite është kredia, a duhet të reflektojë kjo kredi tek ZRRE-ja? Ne duhet të presim sepse në tarifën e viti tjetër duhet marrim parasysht se kjo do t'i rris tarifën për qytetarin a po jo? Unë këtë marrëveshje e mbështes vetëm desha të sqarohem.

**Hekuran Murati:** Kjo marrëveshje e ka paraparë që të huazohen këto mjete tek KEK-u, ky është projekt nga KEK-u si zbatues dhe përfituesit janë ata sepse është investim profitabil. Kjo marrëveshje ka parapa nënhuazim për këtë shumë. Të gjitha marrëveshjet e huazimit parashihet kthimi i borxhit patjetër, sa i përket kësteve kanalizohen nëpërmjet buxhetit të shtetit, por paguhen nga ndërmarrja, siç është KEK-u. Rastet e nënhuazimeve nuk reflektohen si nënshpenzime në buxhetin e shteti, ato vetëm kanalizohen si p.sh. bëhen shpenzim tek KEK-u dhe kanalizohet si hyrje për financim nga KEK-u, kthim i nënhuazimit dhe bëhet pagesa e huamarrjes. Qeveria është siguria e kësaj huamarrjeje, në këtë rast për këtë ndërmarrje. Kredia në nisjen e disbursimit është nga 4 deri në 25 vite maturitet, por të gjitha tarifën reflektojnë në faktuarat e KEK-ut, por varësisht nga norma e kthimit apo nga komponenti apo riinvestimi që ka. Të gjitha shpenzimet e ZRRE-së në fatura të qytetarëve janë të faturuara saktë, në kuadër të KOSTT-it bëhet mbledhja e tarifës dhe ju shpërndahet operatoreve që e fusin energjinë elektrike në objekt.

**Jeta Statovci:** Në mes të këtyre dy ndërmarrjeve është një marrëveshje të KEK-u e KESKOS, dhe këtë marrëveshje e ka aprovua paraprakisht ZRRE-ja, por kjo jodomosdoshmërisht ndikon në tarifën, sepse e ka një çmim fikse e ajo tarifë i përcillet KESK-os, e nuk ndikon në tarifën të konsumatorit por e kanë parapa me këtë marrëveshje që është marrëveshje paraprake e afatgjate.

**Eman Rrahmani:** Për këtë marrëveshje jam deklaruar më herët se jam kundër, sepse ne si LVV kemi premtuar që ta ndërtojmë një termocentral të ri. Ky investim apo rendiment që arrihet me këtë marrëveshje është më i madh se sa të ishte ndërtua një termocentral i ri. Sa i përket ndikimit në tarifa, unë mendoj se ndikon në tarifën e konsumatorit, sepse KEK-ut i rriten shpenzimet dhe investimet në prodhimin e energjisë, pra ka me ndryshua edhe çmimin e faturës, dhe krejt ky dëm është në kurriz të qytetarëve që paguajnë faturat .

**Hekuran Murati:** KEK-u do të prodhojë energji fotovoltaike e cila futet në rrjet edhe kapacitetin e parapare vjetor, futja në rrjet është me 152 gigavatë në orë, aktualisht sot çmimi në bursën HUPEGS është 147 euro gigavatë për import. Nëse KEK-u e lëshon në rrjet me 100 euro gigavatit, do të ishte kthim 15 milionë euro në vit të hyra nga kjo, dhe mund ta paguaj kredinë e KEK-ut, por në anën tjetër për konsumatorin është më lirë në faturimin e tij, sepse nëse reflektohet tarifa 147 euro nga importi do ishte me shtrenjtë, reflektohet 100 euro e vlerës vendore nga KEK-u këtu është përfitimi, se ka edhe më pak import dhe mund të paguhet kredia të cilën e ka marrë KEK-u.

**PAL Lekaj:** Qeveria zotohet për projektet e veta dhe dua të di a ka standarde të dyfishta në këtë marrëveshje sepse sipas njohurisë që kam ti si ministër i financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, keni kërkuar nga Bordi i KOSTT-it që ata të japin garancinë. E kam kundërshtuar këtë sepse KOSTT-i ka dhënë zotimin dhe garancinë për projekt dhe vlera e atij rrisht ka qenë 6.7 milion euro. Ku jeni mbështetur ju si ministër që ata të jenë garantues apo zotues të projektit në këtë marrëveshje, a keni të bëjmë me standardet të dyfishta?

**Hekuran Murati:** Nuk e shoh si standard të dyfishtë por e konsideroj si vlerësim dhe sigurinë e rrishtit të investimeve, natyrisht se investitorët e huaj kërkojnë një siguri shtesë në investimin që bëjnë, por në këtë rast po besoj që siguria shtesë e kërkuar ka qenë për gjendjen financiare të KOSTT-it deri në vitin e kaluar, për shkak të një vendimi të viti 2017, KOSTT-it i është ngarkuar pjesa veriore e furnizimi me energji elektrike. Nga janari i këtij viti, qytetarët e veriut nuk janë me barrë për KOSTT-in sepse qytetarët paguajnë energjinë elektrike, ndërsa KOSTT-i i kthehet profitabilitetit.

**Mergim Lushtaku:** Sa është shuma e përgjithshme e kësaj kredie?

**Hekuran Murati:** Shuma e përgjithshme e kësaj është 104 milionë euro në total.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim dhe konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Te miratohet projektligji nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK-Porta Globale;

**Kryetari:** Pasi që ministri është prezent po i parashtrij disa pyetje sa i përket raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Raporti vjetor sa i përket pranimeve e shfrytëzimeve të mjeteve ka një diskurs që e dëgjojë gjatë, thuhet se po teprojnë qindra milionë euro dhe unë e bëra një analizë sa janë pranuar aq janë shpenzuar apo jo? Bilanci bankar në llogari të BQK-së i referohet rezervës sikur stabilizator automatik, në rast se ka raste të pa pritshme i ke ca mjete të cilat i shfrytëzon, kjo është si rregull, sepse ndër vite e pashë se ka qenë 300 a po 400 milionë euro prej viti 2016. Në vitin 2023 shpenzimet janë reflektuar në të hyra tatimore e jotatimore dhe pranimet e huazimet nga ATK – ja ,dhe nga viti tjetër nuk ka pasur as huazime e as të hyra të tjera, apo jo? Tavani i borxhit publik e tavani i deficitit dhe përqindja e shpenzimeve të cilat mbulohen nga të hyrat tatimore e jotatimore, pra në bazë të dhënave me sa përqindje po mbulohen shpenzimet vjetore nga të hyrat tatimore dhe jotatimore në raport me shpenzimet e përgjithshme?

Tatimet në të ardhurat e korporatave është rritur në vitin 2023, 184 milionë euro, tash është dyfishuar dhe tatimi i të ardhurave personale në viti 2023 është 256 milionë euro, krahasuar me vitin 2022, që kanë qenë 215 milionë euro. Në vitin 2019 ka qenë 165 milionë euro, një rritje për 100 milionë euro ndër vite. ATK- ja po i publikon në baza vjetore pozita që i ka tatimore ndër vite, ata theksojnë se në vitin 2019 i kanë tatimuar 329 mijë pozita dhe në fund të viti 2023 kanë tatimuar 420 mijë pozita, a mund të ma konfirmosh? A po tatimohen 100 mijë vende të punës më shumë se në vitin 2019. ASK - ja raporton se janë 434 mijë vende të punës, kurse ATK-ja thotë se janë 420 mijë vende të punës, a mund të ma konfirmosh sa janë?

Në vitin 2011 kemi pasur 540 milionë të hyra nga TVSh ja, në vitin 2020 kanë qenë 770 milionë euro, e kjo shihet se është dyfishua apo është trefishuar. Detyrimi doganor nuk po shoh se ka lëvizje të madhe, pra s'ka pasur të hyra të shumta. Tek shpenzimet a mundësh me e konfirmua se dividenda në vitin 2009 ka qenë 200 milionë euro, në vitin 2010 ka qenë 58 milionë euro, në vitin 2011 ka qenë 60 milionë euro, në vitin 2012, 45 milionë euro, në vitin 2013 ka qenë 41 milionë euro dhe kam pyetur në thesar prej nga ka qenë burimi i këtyre, ai më është përgjigjur se gjitha këto janë nga Telekomit i Kosovës apo jo? Tha se prej viti 2009 deri ne vitin 2013 dividenda e Telekomit ka qenë 10% deri në 25% e shpenzimeve, të cilat i ka shpenzuar shteti?

Deri ne vitin 2009 - 2013 është financuar Buxheti i Shtetit me dividenda të Telekomit dhe pas vitit 2013, kanë hyrë në borxh publik deri ne vitin 2020. Në tërësi 440 milionë euro të privatizimit janë përdorë për të mbuluar shpenzimet qeveritare apo jo? Kemi kërkuar nga thesari një shpjegim dhe një raport sa i përket borxhit publik dhe në vitin 2023 shpenzimet janë mbuluar në bazë të raportit nga dividenda dhe nga ATK –ja. Strategjia e qeverisë në vitin 2009 dhe 2013 është financuar përmes dividendës, kurse në vitin 2014 dhe 2020 nga Fondi i Privatizimit dhe Huazimi? Pagat kanë qenë në vitin 2023 në shumë prej 767 milionë euro, rreth 150 milionë euro më shumë se në vitin 2019, dhe 100 milionë euro më shumë se në vitin 2021, për paga tani si është gjendja sepse ka qenë një rritje e koeficienteve në vitin 2024 apo jo? Deri ne fund të vitit ASK –ja ka publikuar sa është mesatarja e pagës në sektorin publik, është 713 euro dhe deri në fund të vitit është diku 760 euro apo 792 euro ? Kam pyetur në thesar se sa është paga mesatare për 81, 000 shërbyes civilë dhe më është thënë se paga mesatare është 779.23 euro.

**Hekuran Murati:** Në tri vitet e fundit, pra në vitin 2021 kemi pasur një tkurrje të deficitit, në vitin 2022 deficitit ka qenë 50 milionë euro dhe në vitin 2023, 22,5 milionë euro ka pasur deficit për 3 vitet e kaluara, nuk bëhet fjalë për teprim të mjeteve. Sa i përket të hyrave janë të sakta,



mirëpo, kështu si disbursim ka qenë viti 2023, kemi pasur diku mbi 100 milionë euro disbursim nga huamarrja e jashtme dhe kemi pasur 141 milionë euro nga borxh i brendshëm dhe ne e kemi lënë të amortizohet d.m.th. kemi shpagua 102 milionë ka qenë disbursimi i huamarrjes së jashtme dhe është viti i tretë me radhë që janë mbi 100 milionë euro, dhe ka pasur akuza që po ratifikohen kreditë, por nuk po shfrytëzohen, në të kaluarën ka qenë trendi 40 deri ne 60 milionë euro disbursimi në vit, i kredive të ratifikuara në Kuvend para viti 2020, ndërsa pas vitit 2021 i kemi mbi 100 milionë euro në të tri vitet. Ne si Ministri e Financave, bashkë me agjencitë në këtë rast ATK-në, tek të hyrat e korporatave jemi munduar që të zvogëlohet hendeku tatimor, mosdeklarimi, apo shmangja tatimore, në lidhje me këtë kemi bërë disa fushata sa i përket mbledhjes tatimore për vetëdijesim por edhe ndëshkimit për palë, pra u rritë qarkullimi i bizneseve edhe GDP-ja me shifra që nuk kanë qenë me herët. Rritja ka ardhur nga tatimet personale, që i bie nga pagat dhe kjo nënkupton rritjen në dy drejtime, fillimisht rritja e numri të të punësuarve dhe nëse e krahasojmë fillimin e mandati me tash, deri ne fund te viti 2023 kemi pasur 70 mijë pozita shtesë të deklaruara që paguajnë tatim, janë diku 256 milionë të mbledhura apo 18% me shumë se në vitin paraprak.

**Mergim Lushtaku:** Kjo pikë e rendit të ditës është shumë e rëndësishme dhe them se nuk kemi kuorum, unë mendoj që ta vendosim në ndonjë mbledhje tjetër, mbase duhet t'i bëjmë pyetjet tona që janë përgatitur për këtë raport, kur nuk ka kuorum nuk është mirë me vazhdua pa qenë ne këtu, dhe duhet të jenë edhe mediat dhe të jetë i informuar edhe opinioni se çka ka ky raport çka s'ka.

**Kryetari:** Unë desha t'ju informoj se Ministri i Financave ka një mbledhje dhe ka pak kohë e vetëm për sqarim dhe desha që unë ti parashtoj pyetjet e mia në këtë mbledhje, e pastaj e la radhën tek ju në ndonjë mbledhje tjetër për të diskutuar?

**Hekuran Murati:** Të dhënat janë nga sistemi i ATK- së, siç kanë qenë të deklaruara në vitet paraprake dhe si janë tani shifra konkrete, janë patjetër se ka pasur ngushtim të informalitetit në sektorët e caktuar edhe në sektorët e bujqësisë sepse ka raste për shkak sezonit të punës ose të vetëpunësuarit nuk deklarohen, apo nuk përfshihen nëpër llogaritje, megjithatë ato janë biznese individuale dhe nuk deklarohen si të punësuar, TVSH- ja përafërsisht edhe krahasuar me vitin paraprak ka një rritje për 12% , por nëse e krahasojmë me vitet më hershme, vërehet një shkaputje normës së rritjes, sepse rritja mund të ketë qenë një shifrore apo shtangimi, kryesisht ka qenë Telekom, sepse KEK-u ka pasur një kredi për investime në atë kohë dhe ndërmarrjet tjera kanë operuar o me humbje, o kanë qenë stabile që ta paguajnë dividendën, ajo është paguar në Telekom.

Nëse e marrim gjithë periudhën të cilën e cekët ju, rezulton diku se 2 miliardë e gjysme janë marrë nga kursimet apo nga fondet e ATK- së, apo nga dividenta për të shpenzuar mbi kufijtë e lejuar sipas të hyrave. Ka qenë fondi i AKP-së nga shitja ka qenë 600 milionë euro, 450 janë shpenzuar, kanë mbet, 150 milionë është dallimi, nëse e krahasojmë me vitin paraprak, në vitin 2022 shuma e përgjithshme ka qenë 114 milionë euro, apo 17% rritje për ata zëra se po thuhet nuk ka pasur rritje, por po bëhet fjalë për 114 milionë euro shtesë dhe është dashur të akomodohen si shpenzim në rastin e hyrjes në fuqi të ligjit të pagave të vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 dhe shtesa në vitin 2024 ka qenë në vlerë absolute 40 milionë euro që reflekton rritja e shtesave ka qenë 5%, mbi rritjen 17.6% të viti paraprak, por ka zëra se rritja ka shkuar tek stafet e LVV-së dhe kabinetet politike, dhe më lejoni t'ju them se i tërë shpenzimi për kabinetet

politike nuk e tejkalon 300 mijë euro. Kur bëhet fjalë për 114 milionë euro, ju sqaroj se ku janë shpërndarë ato mjete, Ministria e Financave i publikon për çdo muaj raportet se sa ka shkuar niveli i pagave, në muajin qershor të këtij viti, çeku i pagave ka shkuar në 67.5 milionë euro paga, nëse heqim kontributet 5%, që janë d.m.th. bëhet shifra 760 euro mesatarja, nëse e shohim si kategori në vitin paraprak, kategoria që ka pasur rritje relative, ka qenë kategoria e shpenzimeve kapitale me 33 % rritje krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022 ka qenë 423 milionë, kurse në 2023 ka pasur 560.9 milionë euro shpenzime kapitale, që me terma absolut është shifra më e madhe.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:20.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit**

**Armend Muja,**

-----

**Kryetar i Komisionit**